



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 177

Tiranë – E Enjte, 20 Nëntor 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret nr. 8779 datë 11.11.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 9153
Dekret nr. 8789 datë 12.11.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 9153
Udhëzim i ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr. 16, datë 5.11.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 338/3, datë 10.3.2006, mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”..... 9153
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 26, datë 15.8.2014	Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë..... 9156
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 29, datë 10.9.2014	Për procedurën e pranimi në programet e studimit të ciklit të parë, për shtetasit e huaj që kërkojnë të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2014-2015..... 9164
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 42, datë 15.10.2014	Për arsimimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e paraburgimit, të vuajtjes së dënimit..... 9166
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 44, datë 16.10.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MASH nr. 21, datë 23.7.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”..... 9166
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 51, datë 12.11.2014	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimeve: nr. 00-2012-1498, datë 22.6.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 468, datë 7.12.2009, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe nr. 628, datë 6.5.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë..... 9170

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 14.11.2014	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2013-579, datë 25.4.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	9176
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 96, datë 27.10.2014	Për licencimin e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.....	9183
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 97, datë 27.10.2014	Për licencimin e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. në aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike.....	9183
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 98, datë 27.10.2014	Për përfundimin e administrimit të përkohshëm të shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE).....	9184
Vendim i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr. 145, datë 31.10.2014	Për revokimin e licencës së shoqërisë së sigurimit “Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a.....	9184
Kërkesë e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 6979, datë 13.11.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Shkodër-Hani i Hotit (objekte)”.....	9185
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Dritan Kote.....	9186

**DEKRET**

Nr. 8779, datë 11.11.2014

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ünal Hüseyin Gönül
2. Havva Bekir Gönül (Kaya)
3. Dilara Ünal Gönül
4. Üsâme Ünal Gönül
5. Von Nicholas Quintin Nicholas Golder
6. Susan Jill Earl Stuart Golder (Nicol)
7. Murat Mehmet Fidan
8. Mümin Sevban Murat Fidan
9. Mehmet Enes Murat Fidan
10. Devran Mitat Çakmak (Acar)
11. Osman Nuri Ahmet Cihat Dinler
12. Abdulvahap Mehmet Şahin Yeroğlu
13. Isen Muxhahid Aliji
14. Canan Salih Zeki Gökçek (Sarikoç)
15. Elita Lutvi Zulfeari-Masha (Zulfeari)
16. Faton Shemsedin Çajani
17. Orhan Mustafa Akdağ
18. Çiğdem Ridvan Serbest (Avci)
19. Merita Ukë Berisha (Krasniqi)
20. Frederika Zef Çuni

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET

Nr. 8789, datë 12.11.2014

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin ministrit të Arsimit e Sportit,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ismail Daut Syla
2. Abelard Idriz Tahiri
3. Arbiona Sejdi Bajraktari
4. Lavdiye Tahir Begolli
5. Kushtrim Fadil Bekteshi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

UDHËZIM

Nr. 16, datë 5.11.2014

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 338/3, DATË 10.3.
2006, MBI ZBATIMIN E VKM NR. 787,
DATË 14.12.2005 “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE
TË MASËS SË NDIHMËS EKONOMIKE”**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, dhe në zbatim të pikës 38 të vendimit nr. 787, datë 14.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pika 1, germa “e” e kapitullit IV, të udhëzimit nr. 338/3, datë 10.03.2006, “Mbi zbatimin e VKM nr. 787, datë 14.12.2005, “Për



përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, zëvendësohet me këtë përmbajtje:

“e” personat punëkërkues të papunë që refuzojnë vende pune apo pjesëmarrje në programe të tjera shtetërore. Për këta persona, administratori pas konfirmimit të marrë, nuk vazhdon procedurat e mëtejshme për përfitimin e ndihmës ekonomike”.

2. Në pikën 2 të kapitullit XI, pas paragrafit “projektvendimi do të përmbajë: nr. rendor, emrin dhe mbiemrin e kryefamiljarit....”, shtohet dhe emër mbiemër i bashkëshortes (sipas formularit bashkëngjitur).

3. Në pikën 5 të kapitullit XI, pas paragrafit “vendimi do të përmbajë: nr. rendor, emrin dhe mbiemrin e kryefamiljarit....”, shtohet dhe emër mbiemër i bashkëshortes (sipas formularit bashkëngjitur).

4. Në pikën 7 të kapitullit XI, pas paragrafit “borderoja do të përmbajë: nr. rendor, emrin dhe mbiemrin e kryefamiljarit....”, shtohet dhe emër mbiemër i bashkëshortes (sipas formularit bashkëngjitur).

5. Pika 17 e kapitullit XI ndryshohet si më poshtë vijon:

“17. Ndihma ekonomike e familjes përfituese tërhiqet pranë sporteleve të bankave/Postës Shqiptare nga bashkëshortja. Në rastet kur bashkëshortja ka ndërruar jetë, ndihma ekonomike tërhiqet nga kryefamiljari”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQËNIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj

LISTA QË I BASHKËNGJITET PROJEKT VENDIMIT

Prefektura _____

Rrethi _____

Bashkia, Komuna _____

Lista që i bashkëngjitet projektvendimit në total të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike për periudhën e akorduar

Nr	Emri atësia Mbiemri	Emri atësia mbiemri bashkëshortes	Nr dosjeve	Nr frymëve	Lloji i Ndihmës	Shuma përfituese
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						

Shefi i ndihmës ekonomike
Emri, Atësia, Mbiemri firma

Administratorët Shoqëror
Emri, Atësia, Mbiemri Firma



LISTA QË I BASHKËNGJITET VENDIMIT

Prefektura _____

Rrethi _____

Bashkia, Komuna _____

Lista që i bashkëngjitet vendimit ne total të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike për periudhën e akorduar

Nr	Emri atësia Mbiemri	Emri atësia mbiemri bashkëshortes	Nr dosjeve	Nr frymëve	Lloji i Ndihmës	Shuma përfituese
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						

Sekretari i Këshillit

Kryetari i Këshillit

Emri, Atësia, Mbiemri firma

Emri, Atësia, Mbiemri Firma

BORDERO E PAGESËS SË NDIHMËS EKONOMIKE

Prefektura _____

Rrethi _____

Bashkia, Komuna _____

Bordero e pagesës së ndihmës ekonomike

Për periudhën _____ 20_____

Nr	Emri atësia Mbiemri	Numri ID	Emër Atësia Mbiemër bashkëshortes	Nr dosjeve	Nr frymëve	Lloji i Ndihmës	Shuma përfituese	Nr llogarisë bankare së bashkëshortes *
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								

Shefi i ndihmës ekonomike
Emri, Atësia, Mbiemri firma

Administratorët Shoqëror
Emri, Atësia, Mbiemri Firma

*Në rast se bashkëshortja ka vdekur vendost nr i llogarisë së kryefamiljarit

**UDHËZIM**

Nr. 26, datë 15.8.2014

**PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË
PUNONJËSVE ARSIMORË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 58 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” dhe të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për lejet, autorizimet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:**KREU I****HYRJE****Neni 1****Qëllimi i zhvillimit profesional**

Qëllimi i zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë (drejtor, nëndrejtor, mësues) është përditësimi i njohurive dhe zhvillimi i kompetencave të tyre, në mënyrë që t’u sigurojnë të gjithë nxënësve shërbim arsimor cilësor.

Neni 2**Përkufizime**

Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Institucion arsimor” do të thotë kopsht ose shkollë.

2. “Drejtues” do të thotë drejtor ose nëndrejtor.

3. “Punonjës mësimor” do të thotë mësues, drejtor dhe nëndrejtor.

4. “Programi i trajnimit” përbëhet nga dy a më shumë module trajnimi, të cilat i bashkon një tematikë e përbashkët.

5. “Agjenci trajnuese” janë institucionet e arsimit të lartë, organizatat jofitimprurëse, fondacionet dhe subjekte të tjera që në statutin e tyre kanë për objekt trajnimin e punonjësve arsimorë.

Neni 3**Zhvillimi i brendshëm profesional**

Zhvillimi i brendshëm profesional kryhet në nivel institucioni arsimor nëpërmjet këshillit të mësuesve dhe ekipeve lëndore.

Neni 4**Format e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë**

Format e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë janë:

- a) zhvillimi i brendshëm profesional,
- b) trajnimet,
- c) rrjetet profesionale,
- d) këshillimet,
- e) kurset afatshkurtra dhe kurset afatgjata.

Neni 5**Llojet e trajnimit**

Agjencitë trajnuese mund të zhvillojnë këto lloje trajnimesh:

1. Trajnimi i drejtpërdrejtë, kur trajneri zhvillon seanca trajnuese drejtpërdrejt me pjesëmarrësit në trajnim.

2. Trajnimi nëpërmjet internetit, i kombinuar me konsultime, kur agjencia trajnuese e vendos përmbajtjen e programit/modulit në internet dhe ofron konsultime me të trajnuarit.

3. Trajnimi nëpërmjet internetit, kur agjencia trajnuese vendos vetëm përmbajtjen e programit/modulit në internet.

Neni 6**Kreditet**

1. Një ditë trajnimi përbëhet nga 6 orë, ku 3 orë janë trajnim nga trajneri ose studim i materialit të programit/modulit nga i trajnuari dhe 3 orë punë individuale e të trajnuarit për përgatitjen e detyrave.

2. Një ditë trajnimi pasqyrohet me 2 kredite në certifikatën e të trajnuarit.

3. Një punonjës arsimor duhet të fitojë të paktën 6 kredite gjatë një viti shkollor.

Neni 7**Identifikimi i nevojave për zhvillim profesional**

1. Instituti i Zhvillimeve Arsimor (IZHA), çdo dy vjet zhvillon pyetësorin për të identifikuar nevojat për zhvillim profesional të punonjësve arsimorë.

2. Një herë në dy vjet, formulojnë rekomandime për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë institucionet e mëposhtme:



a) Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), bazuar në politikat kombëtare të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë.

b) Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), bazuar në analizat e provimeve kombëtare.

c) Inspektorati Shtetëror i Arsimit (IShA), bazuar në gjetjet gjatë inspektimeve.

d) IZHA, bazuar në risitë kurrikulare.

e) DAR/ZA-të, bazuar në vëzhgimet e tyre tek institucionet arsimore.

f) Agjencitë trajnuese, me nismën e tyre.

3. IZHA përgatit, çdo dy vjet, studimin “Përparësitë e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë”, bazuar në:

a) Standarde të përgjithshme të mësuesit.

b) Standardet e drejtorit.

c) Nevojat për zhvillim profesional të identifikuar nga IZHA.

d) Rekomandimet e parashikuara në pikën 2.

4. Mbi bazën e studimit “Përparësitë e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë”, IZHA harton, çdo dy vjet, dokumentin “Shpallja e interesit për trajnimin e punonjësve arsimorë”, që përmban një numër programesh/modulesh trajnimi, të cilat u ofrohen për aplikim agjencie trajnuese, gjithashtu, për t’u përzgjedhur për trajnim nga punonjësit arsimorë.

5. “Shpallja e interesit për trajnimin e punonjësve arsimorë” miratohet nga ministri i MAS-it dhe publikohet në faqen e internetit të MAS-it dhe IZHA-s.

KREU II

KOMISIONI I AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE/MODULEVE TË TRAJNIMIT

Neni 8

Komisioni i Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit (KAT)

Komisioni i Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit, më poshtë “KAT”, ngrihet me urdhër të ministrit të MAS-it.

Neni 9

Përbërja e KAT-it dhe sekretariati

1. KAT-i përbëhet nga 7 anëtarë, një prej të cilëve është drejtori i IZHA-s. Kryetari i KAT-it është një nga 7 anëtarët, i cili zgjidhet me

shumicë të thjeshtë votash në mbledhjen e parë të KAT-it.

2. Ministri i MAS-it urdhëron zëvendësimin e kryetarit dhe anëtarit të KAT-it:

a) kur mungon në më shumë se 30% të mbledhjeve të KAT-it për një periudhë dyvjeçare;

b) kur provohen shkelje gjatë kryerjes së detyrës sipas këtij udhëzimi ose të deklaratës së konfliktit të interesave (shtojca 1).

3. Sektori i Kualifikimit dhe i Karrierës në IZHA dhe juristi i këtij institucioni kryejnë funksionin e sekretariatit të KAT-it.

Neni 10

Detyrat e kryetarit të KAT-it

Kryetari i KAT-it ka këto detyra:

1. Thërret mbledhjet e KAT-it.

2. Miraton rendin e ditës së çdo mbledhje.

3. Drejton mbledhjet.

4. Paraqet te ministri i MAS-it raportin vjetor të veprimtarisë së KAT-it, i cili miratohet nga KAT-i.

5. Në mungesë të kryetarit, mbledhjen e drejton një nga anëtarët e tij, i paracaktuar nga kryetari.

6. Detyra të tjera të kryetarit përshkruhen në këtë udhëzim.

Neni 11

Detyrat e Sekretariatit të KAT-it

Sekretariati i KAT-it ka këto detyra:

1. Njofton anëtarët e KAT-it për mbledhjet e tij.

2. Mban procesverbalin e mbledhjeve të KAT-it, ku shënohet edhe pjesëmarrja e anëtarëve, dhe e shpërndan anëtarëve të KAT-it.

3. Përditëson bazën e të dhënave për një program/modul të akredituar.

Baza e të dhënave përmban: emri i agjencisë trajnuese, numri dhe data e vendimit të akreditimit, numri i certifikatës së akreditimit dhe data e lëshimit të saj, tema dhe kodi i programit/modulit, numri i krediteve të programit/modulit dhe numri total i krediteve që punonjësit arsimorë kanë fituar nga programi/moduli.

4. Ruan në arkivin e KAT-it:

a) procesverbalet e mbledhjeve të KAT-it dhe aplikimet e agjencie trajnuese për një vit nga data e hartimit të tyre;

b) vlerësimet e aplikimeve, kopjet e



certifikatave të akreditimit dhe masat ndaj agjencive trajnuese për 5 vjet nga datat hartimit të dokumenteve përkatëse.

5. Detyra të tjera të sekretariatit përshkruhen në këtë udhëzim.

Neni 12

Vendimet e KAT-it

1. KAT-i i merr vendimet me të paktën 2/3 e anëtarëve të tij. Kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

2. Sekretarët e KAT-it nuk kanë të drejtë vote.

3. Vendimet e KAT-it nënshkruhen nga kryetari dhe anëtarët pjesëmarrës në marrjen e vendimit.

KREU III

SHPALLJA E INTERESIT PËR TRAJNIME DHE APLIKIMI I AGJENCIVE TRAJNUESE

Neni 13

Shpallja e interesit për trajnime

1. IZHA publikon në faqen e saj internetit, brenda muajit shtator, dokumentin “Shpallja e interesit për trajnimin e punonjësve arsimorë”.

2. Me porosi të ministrit, në çdo periudhë të vitit kalendarik, IZHA shpall interesin për tematika të tjera trajnimi, sipas risive të reformave.

Neni 14

Aplikimi i agjencive trajnuese dhe afati

Agjencitë trajnuese, brenda majit tetor, bazuar në dokumentin e shpalljes së interesit, aplikojnë pranë sekretariatit të KAT-it për programe/module të caktuara trajnimi.

Neni 15

Dokumentacioni i aplikimit për një modul

Dokumentacioni i aplikimit përmban këto të dhëna për një program/modul:

1. Emri i agjencisë trajnuese.

2. Të dhënat e kontaktit (adresa e postës elektronike, numri i celularit, linku i faqes së internetit të agjencisë, nëse ka).

3. Një kopje e noterizuar e dokumentit juridik të statusit të agjencisë.

4. Tri kopje të formatit të plotësuar të aplikimit për secilin modul (shtojca 2).

5. CV-të e trajnerëve (shtojca 3).

6. Numri total i krediteve që punonjësit arsimorë kanë fituar në këtë modul nga kjo agjenci.

Neni 16

Trajnerët

Kanë të drejtë të jenë trajnerë për një program/modul trajnimi:

1. Pedagogët e institucioneve të arsimit të lartë të programeve të studimit të mësuesisë që kanë përvojë të paktën 5-vjeçare në një programin/modulin e trajnimit.

2. Specialistë në fushën e arsimit parauniversitar që kanë përvojë të paktën 5-vjeçare për programin/modulin.

3. Specialistë/punonjës arsimorë që janë certifikuar në kurs afatgjatë, brenda ose jashtë vendit, për aspekte arsimore që përfshin programin/modulin.

4. Punonjës arsimorë ose ish-punonjës arsimorë që kanë ose kanë pasur përvojë të paktën 5-vjeçare për programin/modulin.

5. Punonjës ose ish-punonjës të institucioneve shtetërore që kanë ose kanë pasur përvojë të paktën 5-vjeçare për programin/modulin.

KREU IV

VLERËSIMI I MODULEVE

Neni 17

Shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit nga sekretariati

1. Shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit të agjencive trajnuese kryhet brenda muajit nëntor.

2. Sekretariati shqyrton dokumentacionin e aplikimit dhe i raporton me shkrim KAT-it për dy aspekte:

a) Përputhja e statusit të agjencisë me programin/modulin e trajnimit për të cilën aplikon.

b) Plotësia e dokumentacionit të aplikimit (shtojca 4).

Neni 18

Shqyrtimi i dokumentacionit të aplikantit nga KAT

KAT-i, bazuar në raportin e sekretariatit, merr njërin nga këto vendime:

1. Pranon aplikimin e agjencisë.

2. Nuk pranon aplikimin e agjencisë, kur



agjencia nuk ka në statusin e saj zhvillimin e trajnimeve për të cilën aplikon.

3. Kthen aplikimin për plotësime ose saktësime, brenda 5 ditëve nga njoftimi për plotësim/saktësim, kur ka mungesa ose pasaktësi në dokumentacionin e aplikimit.

Neni 19

Plotësimi i dokumentacionit nga agjencia trajnuese

1. Agjencia trajnuese nuk ka të drejtë, që gjatë plotësimit të dokumentacionit me kërkesën e KAT-it, të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj.

2. Një agjencie trajnuese i jepet vetëm një herë mundësia për të plotësuar dokumentacionin e aplikimit. Kur dokumentacioni nuk plotësohet brenda afatit 5-ditor të përcaktuar ose ka përsëri mangësi, sekretariati i KAT-it nuk e paraqet aplikimin e agjencisë për shqyrtim në KAT.

Neni 20

Vlerësuesit e moduleve

1. IZHA shpall, një herë në dy vjet, brenda muajit shtator, kërkesën për vlerësues të moduleve.

2. Kandidati për vlerësues dorëzon CV-në në sekretariatën e KAT-it (shtojca 3).

3. Kandidati për vlerësues është mësues ose specialist që zotëron njohuri të mjaftueshme për modulën, të dëshmuara në CV-në e tij.

4. Pranohet për vlerësues:

a) mësuesi që është vlerësuar me “Shkëlqyeshëm” ose “Shumë mirë” në provimin e fundit të kualifikimit.

b) Drejtori, institucioni arsimor që është vlerësuar me të paktën “Mirë” nga Inspektorati Kombëtar i Arsimit (ISHA) brenda katër viteve të fundit shkollorë ose shkolla, që drejton, është përfshirë ndër shkollat e suksesshme në një nga dy vitet e fundit shkollorë.

c) Sekretariati i KAT-it përpilon listën e kandidatëve për vlerësues.

5. KAT-i shqyrton kandidatët për vlerësim, të paraqitura nga sekretariati, dhe miraton ose nuk miraton kandidatë.

Neni 21

Vlerësimi moduleve

1. Vlerësimi i moduleve të trajnimit realizohet brenda muajit nëntor.

2. Sekretariati përgatit vlerësuesit për procedurën e vlerësimit të moduleve të trajnimit.

3. Formatet e vlerësimit nuk duhet të përmbajnë ndonjë shenjë dalluese të agjencisë, por vetëm një kod të vendosur nga sekretariati.

4. Sekretariati organizon veprimtarinë e vlerësimit.

5. Një modul trajnimi vlerësohet nga dy vetë, të cilët fillimisht e vlerësojnë modulën duke qenë në mjedise të ndryshme, pastaj krahasojnë së bashku vlerësimet dhe arrijnë në një vlerësim të vetëm.

6. Çdo grup vlerësuesish plotëson formatin e vlerësimit për çdo modul (shtojca 5), duke analizuar shtojcën 2 të plotësuar nga agjencia, dhe e dorëzon te sekretariati i KAT-it.

7. Sekretariati nuk ka të drejtë t'i ndryshojë vlerësimet që kanë bërë grupet e vlerësimit dhe as t'i kërkojë ndonjë grupi të ndryshojë vlerësimin e tij.

8. KAT-i e miraton dokumentacionin e grupit të vlerësimit ose e kthen për plotësime ose/dhe saktësime, ose/dhe shtjellim më të plotë të argumenteve.

KREU V

AKREDITIMI I

PROGRAMEVE/MODULEVE TË TRAJNIMIT

Neni 22

Akreditimi i programeve/moduleve të agjencive trajnuese

1. Një program trajnimi është i akredituar kur janë të akredituara të gjitha modulet që e përbëjnë.

2. KAT-i ka këto detyra për akreditimin e programeve/moduleve të agjencive trajnuese:

a) Shqyrton, brenda muajit dhjetor, formatet e plotësuar nga grupet e vlerësimit.

b) Vendos se cilat module do të akreditohen.

c) Vendos për numrin e krediteve të çdo moduli sipas nenit 6 të këtij udhëzimi.

3. KAT-i ka të drejtë:

a) të kthejë vlerësimin e ndonjë grupi vlerësimi për plotësime, ose/dhe saktësime, ose/dhe argumentime më të plota;



b) të konsultohet, për numrin e krediteve, me specialistë të modulit.

c) të thërrasë një grup vlerësimi për paqartësi të mundshme në vlerësimin e kryer prej tij.

4. KAT-i nuk ka të drejtë t'i kërkojë ndonjë grupi të ndryshojë vlerësimet dhe as t'i ndryshojë vetë ato.

Neni 23

Akreditimi i më shumë se një agjencie

1. Për një program/modul trajnimi mund të akreditohen disa agjenci trajnuese.

Neni 24

Certifikata e akreditimit

1. Sekretariati përgatit vendimet e akreditimit dhe certifikatat e akreditimit dhe i paraqet te kryetari i KAT-it.

2. Kryetari i KAT-it ndjek procedurat e legjitimitetit të akreditimit për agjencitë fituese.

3. Sekretariati njofton agjencitë fituese brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i dokumenteve që i jep të drejtën agjencisë të kryejë trajnime me punonjësit arsimorë.

4. Certifikata e akreditimit për një program/modul trajnimi është e vlefshme për katër vjet nga data e nënshkrimit të saj, përveç rasteve të veçanta, me vendim të KAT-it.

5. Pas përfundimit të vlefshmërisë së certifikatës, agjencia mund të aplikojë për përtëritjen e saj, sipas procedurave të aplikimit të përshkruara në këtë udhëzim.

Neni 25

Ankimi

1. Agjencia trajnuese ka të drejtën e ankimit te ministri i MAS-it brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e KAT-it.

2. Ministri shqyrton ankimet sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe kuadrit ligjor në fuqi.

KREU VI

PLOTËSIMI I KËRKESAVE PËR TRAJNIME NGA PUNONJËSIT ARSIMORË

Neni 26

Njoftimi i punonjësve arsimorë për trajnimet

1. Agjencia trajnuese e akredituar për një program/modul trajnimi të drejtpërdrejt, dërgon,

një muaj para zhvillimit të trajnimit të drejtpërdrejt, me postë elektronike, te DAR/ZA-të ku ofron trajnimin, sekretariati dhe ISHA, këto të dhëna:

a) Emri i agjencisë.

b) Të dhënat e kontaktit.

c) Mjedi (mjediset) ku agjencia ofron trajnimin e programit/modulit, të përshkruara me saktësi.

d) Datat që agjencia ofron trajnimin.

e) Tema dhe rezultatet e pritshme të programit/modulit të trajnimit.

f) Numri total i krediteve që punonjësit arsimorë kanë fituar në këtë modul nga kjo agjenci.

2. Agjencia trajnuese e akredituar për një program/modul trajnimi nëpërmjet internetit, e kombinuar me konsultime, njofton në internet datat që agjencia ofron konsultimet, kur janë të drejtpërdrejta.

3. Agjencia trajnuese e akredituar për një program/modul trajnimi nëpërmjet internetit njofton dhënat e parashikuara në shkronjat “b”), “e”) dhe “f”) të pikës 1 të këtij neni.

4. DAR/ZA-të njoftojnë menjëherë me postë elektronike ose shkresë drejtorët e institucioneve arsimore përfituese nga trajnimi dhe organizon një takim me ta.

5. Drejtorët e institucioneve përfituese nga trajnimi të drejtpërdrejt njoftojnë çdo punonjës arsimor të institucionit të dhënat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

6. IZHA publikon të dhënat për trajnimet vjetore në faqen e vet të internetit.

Neni 27

Përzgjedhja e moduleve nga punonjësi arsimor

1. Punonjësi arsimor përzgjedh programet/modulet e akredituara të drejtpërdrejt bazuar në të dhënat e parashikuara në pikën 1 të nenit 25.

2. Në raste të veçanta, drejtorja, pas marrjes së mendimit nga këshilli i mësuesve, përcakton kriteret për caktimin e mësuesve që do të trajnohen nga një agjenci për një program/modul trajnimi.

3. Titullari, punonjësit e DAR/ZA-së dhe drejtori i institucionit arsimor e kanë të ndaluar që të ndikojnë të punonjësi arsimor i institucionit në përzgjedhjen e agjencisë trajnuese.

4. Drejtori i institucionit arsimor për



punonjësit arsimor të institucionit ose DAR/ZA-ja për punonjësit arsimorë të institucioneve në juridiksion, nëpërmjet postës elektronike, njoftojnë agjencinë përkatëse për pjesëmarrjen në një program/modul të caktuar të punonjësve arsimorë.

5. Agjencia trajnuese njofton drejtorin e institucionit arsimor për datën dhe orën e zhvillimit të seancave trajnuese të drejtpërdrejta.

KREU VII ZHVILLIMI I TRAJNIMEVE DHE TESTIMET

Neni 28

Zhvillimi i trajnimeve

1. Njësitë arsimore vendore, në bashkëpunim me agjenci trajnuese dhe drejtoritë e institucioneve arsimore, organizojnë zhvillimin e trajnimeve të drejtpërdrejta të punonjësve arsimor me programet/modulet e trajnimit të akredituara.

2. Numri i pjesëmarrësve në një seancë trajnimit të drejtpërdrejt nuk është më i madh se 25, me përjashtim të rasteve kur metoda e vetme e trajnimit është leksioni.

3. Trajnimet zhvillohen pa cenuar orarin mësimor.

4. Titullari i DAR/ZA-së ka për detyrë të njoftojë sekretarinë e KAT-it për mosrespektim nga agjencia të datave të seancave trajnuese.

Neni 29

Testimi

1. Për të fituar kreditet e një moduli, punonjësi arsimor i nënshtrohet testimit për atë modul.

2. Testi për një modul vlerëson sa të trajnuarit përmbushin rezultatet e pritshme të modulit të trajnimit.

3. Punonjësi arsimor, para testimit, dorëzon në agjenci portofolin e tij i cili përmban detyrat që i trajnuari ka kryer gjatë trajnimit.

4. Agjencia trajnuese vendos nëse do t'i nënshtrohet ose jo provimit një i trajnuar, bazuar:

a) në përmbajtjen e portofolit të tij;

b) në ndjekjen e orëve trajnuese, kur trajnimi është i drejtpërdrejt. (Jo më pak se 90% e orëve për një modul).

5. Testimi zhvillohet në një datë dhe në mjediset e paralajmëruara nga agjencia.

6. Testimi është me shkrim. Agjencia trajnuese ka të drejtë të zhvillojë testim me gojë me të gjithë ose disa të trajnuar.

Neni 30

Rezultatet e testimit dhe ankimi

1. Agjencia trajnuese njofton secilin të trajnuar për rezultatin në testim.

2. Pjesëmarrësi në testim ka të drejtë të ankohet me shkrim ose postë elektronike te drejtuesi i agjencisë trajnuese, brenda 5 ditëve nga njoftimi i rezultateve, dhe të marrë përgjigje me shkrim prej tij brenda 10 ditëve nga dorëzimi i ankesës.

3. Rezultati i testit të një të trajnuari mund të ndryshohet, kur e vendos komisioni i ngritur nga drejtuesi i agjencisë trajnuese.

4. Fletë-testet me përgjigjet e të trajnuarve ruhen nga agjencia për një vit nga data e zhvillimit të provimit dhe janë objekt i inspektimit nga ISHA.

Neni 31

Certifikata

1. Certifikata e një moduli i jepet punonjësit arsimor, kur në testim ka grumbulluar të paktën 75% të pikëve.

2. Në certifikatë shënohen emërtimi i programit/modulit dhe numri përkatës i krediteve.

3. Certifikatat përgatiten nga agjencia trajnuese, nënshkruhen nga drejtuesi i agjencisë dhe kanë vullën e agjencisë trajnuese.

4. Mësuesi i certifikuar për një program/modul njofton drejtorin e institucionit arsimor për temën e programit/modulit.

Drejtori i institucionit arsimor, që është certifikuar për një program/modul, njofton titullarin e njësisë arsimore vendore përkatëse për temën e programit/modulit.

5. Drejtoria e institucionit arsimor dhe sektori i programeve të zhvillimit në DAR/ZA mbajnë bazën e të dhënave të drejtuesve dhe mësuesve të certifikuar.

6. Agjencitë trajnuese dorëzojnë në sekretariat listën e punonjësve arsimorë të certifikuar nga kjo agjenci për çdo modul të akredituar.



KREU VIII
MONITORIMI DHE VLERËSIMI I
TRAJNIMIT NGA AGJENCITË
TRAJNUESE TË AKREDITUARA

Neni 32

Monitorimi dhe vlerësimi

1. Monitorimi dhe vlerësimi i seancave trajnuese kryhet nga MAS, IZHA, dhe DAR/ZA-të, sipas juridiksionit të tyre. (Shtojca 6) ISHA inspekton zhvillimin e seancave trajnuese.

Shtojca 6 e plotësuar i dërgohet sekretarisë së KAT-it.

2. Sekretariati i paraqet KAT-it raportet e vlerësimeve të agjencive trajnuese.

KREU IX
PROPOZIME PËR MASA

Neni 33

Masat administrative dhe përgjegjësia penale

1. MAS dhe institucionet e varësisë, IZHA, ISHA, dhe DAR/ZA-të sipas juridiksionit të tyre, i propozojnë ministrit të MAS-it të marrë masa administrative ose të kërkojë përgjegjësi penale ndaj një agjencie trajnuese, kur agjencia:

- a) kryen shkelje të këtij udhëzimi;
- b) falsifikon të dhënat në dokumentacionin e aplikimit ose ato në faqen e saj në internet.

2. Sipas shkallës së shkeljes, propozimi për masë është:

a) Paralajmërim i pezullimit të veprimtarisë së agjencisë trajnuese (Agjencia paralajmërohet vetëm një herë gjatë një periudhe katërvjeçare).

b) Pezullimi i veprimtarisë së agjencisë trajnuese për një program/modul për 1 (një) vit.

c) Heqja e së drejtës së trajnimit për një program/modul të caktuar.

d) Ndalimi i agjencinë trajnuese që të aplikojë për dy vjet.

3. Sekretariati përditëson të dhënat për masat administrative të vendosura nga MAS-i ndaj agjencive trajnuese.

KREU X
KURSET AFATSHKURTRA

Neni 34

Kurset afatshkurtra (seancat informuese) të organizuara nga IZHA, AKP dhe ISHA

1. Institucionet qendrore, IZHA, AKP dhe ISHA, kanë të drejtë të zhvillojnë kurse afatshkurtra me specialistë të DAR/ZA-ve dhe punonjës arsimorë për risitë e reformave arsimore, aktet e reja nënligjore të ministrit të MAS-it dhe udhëzuesit e këtyre institucioneve.

2. Tematika dhe përmbajtja e kurseve afatshkurtra miratohet nga ministri i MAS-it.

3. Kreditet e kurseve afatshkurtra përcaktohen nga KAT-i sipas nenit 6 të këtij udhëzimi.

4. IZHA, AKP dhe ISHA publikojnë në faqen e tyre të internetit njoftimet për tematikat e kurseve afatshkurtra dhe përmbajtjen e seancave informuese të kurseve.

5. Pjesëmarrësit në një kurs afatshkurtër, të zhvilluar nga institucionet qendrore të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, i nënshtrohen provimit:

a) me teste të hartuara dhe përgjigjet e vlerësuara nga grupe pune të ngritura nga titullari i institucionit qendror;

b) sipas rregullave të korrektesës të përshkuara në rregulloren e posaçme të nënshkruar nga titullari i institucionit qendror.

6. Certifikimi është në përputhje me pikat 1, 2, 4, 5, 6 të nenit 30. Certifikata ka firmën e titullarit të institucionit qendror dhe vulën e institucionit.

Neni 35

Kurset afatshkurtra (seancat informuese) të organizuara nga DAR/ZA-të

1. DAR/ZA-të organizojnë kurse afatshkurtra me punonjësit përkatës arsimorë, si vazhdim i kurseve afatshkurtra të zhvilluara nga institucionet e parashikuara në pikën 1 të nenit 35.

2. Kanë të drejtë të zhvillojnë kurse afatshkurtra në nivel DAR/ZA-je vetëm specialistë të DAR/ZA-ve dhe punonjës arsimorë të cilët janë certifikuar në kurset përkatëse të zhvilluar nga institucionet e parashikuara në pikën 1 të neni 35.

3. Punonjësit arsimorë, që marrin pjesë në



kurset afatshkurtra të zhvilluara në nivel DAR/ZA-je i nënshtrohen provimit dhe certifikohen nga titullari i DAR/ZA-së. Certifikata ka firmën e titullarit të DAR/ZA-së dhe vulën e saj.

4. Testet e çdo provimi hartohen nga institucioni përkatës qendror dhe dërgohet në çdo DAR/ZA në kushtet e sigurisë dhe korrektesës.

5. Testet vlerësohen nga grupe punë të ngritura nga titullari i DAR/ZA-së.

KREU XI RRJETET PROFESIONALE

Neni 36 Qëllimi

Rrjeti profesional ka për qëllim zhvillimin profesional të punonjësve të institucioneve arsimore nëpërmjet shkëmbimit të përvojave dhe mendimeve të anëtarëve të tij për praktikën e punës së tyre të përditshme.

Neni 37 Pjesëmarrja në rrjet

1. Në një rrjet profesional (rrjet), bëjnë pjesë jo më shumë se 20 punonjës arsimorë, si më poshtë:

- Drejtues të shkollave.
- Mësues të arsimit fillor.
- Mësues të një lënde në një nivel arsimor.
- Mësues të së njëjtës fushë të nxëni në një nivel arsimor.
- Mësues kujdestar.

2. Anëtarët e rrjetit, që e kanë të mundur, formojnë, gjithashtu, një rrjet në internet, nëpërmjet të cilit, ndërmjet dy takimeve të rrjetit, shkëmbejnë përvoja, parashtojnë pyetje dhe marrin përgjigje nga kolegë.

Neni 38 Takimet e rrjetit

1. Në çdo takim të rrjetit shtjelohet një temë për praktikën e punës së përditshme e cila planifikohet nga drejtuesi i rrjetit në bashkëpunim me anëtarët e tij.

2. Gjatë një viti shkollor, sipas rolit të tij, një rrjet mund të takohet:

- vetëm një herë;
- vetëm disa herë;
- rregullisht.

3. Shpeshtësia e takimeve të rrjeteve përcaktohet nga DAR/ZA-ja.

4. Takimet e një rrjeti zhvillohen në mjediset e një institucioni arsimor.

5. Një takim i një rrjeti profesional zgjat të paktën 60 minuta.

Neni 39 Detyra të DAR/ZA-ve

1. DAR/ZA-ja:

- organizon një numër të caktuar rrjetesh, sipas përparësive të saj;
- vëzhgon zhvillimin e takimeve të rrjeteve dhe vlerëson cilësinë e tyre.

2. Titullari i DAR/ZA-së cakton specialistët e DAR/ZA-së për të organizuar, vëzhguar dhe vlerësuar rrjete të caktuara.

3. Çdo specialist i DAR/ZA-së harton raportin e vlerësimit për rrjetin e vëzhguar (shtojca 7) dhe i dorëzon nga një kopje të vlerësimit drejtuesit të rrjetit dhe përgjegjësit të sektorit të kurrikulës.

4. Specialistët, që mbulojnë veprimtarinë e rrjeteve, organizojnë një herë në tre muaj, takime me drejtuesit e tyre për të shkëmbyer mendime për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë së rrjeteve.

5. Çdo specialist i paraqet përgjegjësit të sektorit të kurrikulës listën e pjesëmarrjes në rrjetet që mbulon.

6. Përgjegjësi i sektorit të programeve të zhvillimit përditëson të dhënat për pjesëmarrjen në rrjete të punonjësve të institucioneve arsimore dhe i dërgon drejtorit të çdo institucioni arsimor pjesëmarrjen në rrjet të punonjësve arsimorë të institucionit.

Neni 40 Drejtuesi i rrjetit

1. Drejtuesi i rrjetit:

- ka përgjegjësi për zhvillimin cilësor të takimeve të rrjetit nëpërmjet organizmit të përgatitjes paraprake të anëtarëve të rrjetit;
- drejtton takimet e rrjetit;
- plotëson listën e pjesëmarrjes me nënshkrimin e çdo pjesëmarrësi dhe e dorëzon te specialisti përkatës i DAR/ZA-së.

2. Drejtuesi i rrjetit duhet:

- të ketë punuar të paktën 10 vjet si mësues. Parapëlqehen mësues që janë vlerësuar



“Shkëlqyeshëm” ose “Shumë mirë” në provimet e kualifikimit.

b) “Shkëlqyeshëm” ose “Shumë mirë” në modulet e trajnimit, nëse ka marrë pjesë në to.

3. Drejtuesi i rrjetit zëvendësohet me kërkesën e anëtarëve të rrjetit ose nga sektori i programeve të zhvillimit në DAR/ZA.

KREU XII

KËSHILLIMET DHE ASPEKTE TË TJERA TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL

Neni 41

Këshillimet

1. DAR/ZA-të planifikojnë dhe organizojnë këshillimin e punonjësve arsimorë:

a) për çështje të praktikës së përditshme të menaxhimit të institucionit arsimor dhe të mësimdhënies e nxënies;

b) për zbatime të udhëzimeve të reja të MAS-it ose udhëzuesve të njëjësive të varësisë së saj qendrore.

2. Këshillimi realizohet:

a) sipas një kalendarit të vendosur nga titullari i DAR/ZA-së, në mjediset e saj ose të një institucioni arsimor, nga specialistë të DAR/ZA-së ose punonjës arsimorë të përzgjedhur prej saj;

b) nëpërmjet letrave qarkulluese që u dërgohen institucioneve arsimore.

Neni 42

Përhapja e praktikave të suksesshme

1. ISHA grumbullon, gjatë inspektimeve, praktikat e suksesshme të institucioneve dhe të punonjësve të veçantë arsimorë, i publikon një herë në vit në faqen e vet të internetit.

2. DAR/ZA-të, gjatë vëzhgimeve në institucionet arsimore, grumbullojnë praktika të suksesshme të institucioneve arsimorë dhe të punonjësve të veçantë arsimorë, i qarkullojnë nëpërmjet letrave të tyre dhe i publikojnë, herë pas here, në faqen e tyre të internetit.

3. IZHA:

a) publikon në faqen zyrtare materiale në ndihmë të mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore;

b) grumbullon praktika të suksesshme, gjatë komunikimeve me punonjës arsimorë, i boton një herë në vit i publikon në faqen e vet të internetit;

c) përdor faqen e saj zyrtare për shkëmbime

Faqe|9164

mendimesh dhe përvojash në mes punonjësve arsimorë.

KREU XIII

Neni 43

Dispozita të fundit

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi MAS-i, IZHA, AKP, ISHA, DAR/ZA-të, institucionet arsimore dhe agjencitë trajnuese.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 29, datë 10.9.2014

PËR PROCEDURËN E PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, PËR SHTETASIT E HUAJ QË KËRKOJNË TË STUDIOJNË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2014-2015

Në mbështetje të nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikës 1 ç dhe pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 517, datë 1.8.2014 “Për kuotat e pranimit të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, në programet e studimeve jo-universitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2014-2015”,

UDHËZOJ:

1. Studentët e huaj që aplikojnë individualisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit apo në kuadër të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe ose shumëpalëshe, për ndjekjen e studimeve në ciklin e parë të studimeve, për vitin akademik 2014-2015, të përzgjidhen për programin e studimit të kërkuar, në bazë të dosjeve të aplikantëve të përcjella individualisht nga vetë të interesuarit ose të ardhura nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, nga



ministritë e arsimit të vendeve përkatëse ose nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

2. Studentët e huaj duhet të paraqesin në Drejtorinë e Integritimit dhe Projekteve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në periudhën 10 shtator 2014 - 1 tetor 2014 dokumentet e mëposhtme:

a) Formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi;

b) Vërtetim që nuk ka qenë i ndjekur penalisht dhe që nuk është në ndjekje penale, në vendin e origjinës, i lëshuar 3 muajt e fundit;

c) Fotokopjen e njësuar të dokumentit personal të identitetit;

d) Fotokopjen e njësuar të origjinalit të legalizuar të diplomës së shkollës së mesme e shoqëruar nga një dokument të lëshuar nga autoritetet arsimore kompetente që dëshmon se mbajtësi i diplomës ka të drejtë të ndjekë studimet në institucione të arsimit të lartë në vendin e tij/saj;

e) Certifikatë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë së Universitetit të Tiranës, dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument që provon njohjen e gjuhës shqipe në nivelin e kërkuar (për shembull, diplomë e kryerjes së një cikli studimi në gjuhën shqipe, etj.);

f) Kopjen e njësuar të origjinalit të leje qëndrimit për shtetasit e huaj, lëshuar nga Ministria e Brendshme, nëse disponohet nga aplikuesi;

g) Curriculum Vitae;

h) Deklaratë sipas shtojcës nr. 2 të këtij udhëzimi.

3. Kur dokumentacioni paraqet mangësi, Drejtoria e Integritimit dhe Projekteve i kërkon aplikantit plotësimin e tij brenda datës 1 tetor 2014. Drejtoria e Integritimit dhe Projekteve dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, shqyrtojnë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi dhe, në rastet kur numri i kërkesave është më i lartë se ai i kuotave të miratuara për shtetasit e huaj për ciklin përkatës të studimit, bëjnë renditjen e kandidatëve sipas kriterit të

meritës dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues në programet e studimit përkatës, bazuar dhe në kapacitetet pritëse të IAL-ve. Kërkesat e aplikantëve që nuk kanë dorëzuar dokumentacion të plotë, sipas specifikimeve në këtë udhëzim brenda afateve të parashikuara, nuk do të merren në shqyrtim.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit i dërgon institucioneve publike të arsimit të lartë, brenda datës 3 tetor 2014, dokumentacionin përkatës të aplikantëve të përzgjedhur sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, për të kryer procedurat e mëtejshme të regjistrimit në programet e studimit përkatës.

5. Shtetasit e huaj brenda datës 17 tetor 2014 paraqiten pranë sekretarive mësimore të fakulteteve përkatëse për të përfunduar procedurat e regjistrimit në programin përkatës të studimit.

6. Brenda datës 3 nëntor 2014 institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKP) listat përfundimtare në dy kopje, në formë të shkruar dhe elektronike, me regjistrimet e kryera për shtetasit e huaj, për çdo program studimi, të plotësuar, sipas shtojcës nr. 3 të udhëzimit nr. 45 datë 19.12.2011 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, të ndryshuar. AKP përgatit dhe i përcjell IAL-ve përkatëse numrat e matrikullimit të shtetasve të huaj brenda datës 3 dhjetor 2014.

7. Ngarkohen Zëvendësministri për Arsimin e Lartë, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Drejtoria e Integritimit dhe Projekteve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet publike të arsimit të lartë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

**UDHËZIM****Nr. 42, datë 15.10.2014**

**PËR ARSIMIMIN E INDIVIDËVE TË
MOSHËS SHKOLLORE NË
INSTITUCIONET E PARABURGIMIT,
TË VUAJTJES SË DËNIMIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 18 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Realizimin e arsimimit të individëve të moshës shkollore, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme në institucionet e paraburgimit/të vuajtjes së dënimit.

2. Procesi mësimor për arsimin bazë në institucionet e paraburgimit/të vuajtjes së dënimit të zhvillohet duke grupuar nxënësit në klasa të bashkuara, sipas grupmoshave përkatësisht në grupin e klasave I-III, IV-VI dhe VII-IX.

3. Arsimitimi në institucionet e paraburgimit/të vuajtjes së dënimit të zhvillohet në përputhje me kurrikulën e arsimit publik.

Struktura e vitit mësimor të jetë e njëjtë me shkollat publike.

4. Klasat në institucionet e paraburgimit/të vuajtjes së dënimit të varen nga një shkollë pranë njësisë administrative të institucionit.

5. Drejtoria e shkollës, që ka në varësi klasat në institucionet e paraburgimit/të vuajtjes së dënimit, të përfshijë të gjithë nxënësit e këtyre klasave në dokumentacionin bazë të shkollës.

Çdo mësues i këtyre klasave të mbajë dokumentacionin përkatës dhe të dhënat përfundimtare të hidhen në amzën e shkollës.

6. Mësuesit, që do të realizojnë procesin mësimor në institucionet e paraburgimit/të vuajtjes së dënimit, të sigurohen brenda numrit të mësuesve në organikën e shkollave publike që kanë në varësi klasat në institucionet e paraburgimit/të vuajtjes së dënimit.

7. Instituti i Zhvillimit të Arsimit të përgatisë planet mësimore dhe programet lëndore për klasat në institucionet e paraburgimit/të vuajtjes së dënimit.

Faqe|9166

8. Njësitë arsimore vendore (DAR/ZA), të cilat kanë nën juridiksionin e tyre shkolla që trajtojnë arsimimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e paraburgimit/të vuajtjes së dënimit, të zbatojnë aktet ligjore dhe nënligjore për arsimimin e tyre, si dhe marrëveshjen e bashkëpunimit lidhur më 24.06.2014, ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Drejtësisë “Për arsimimin e individëve në institucionet e paraburgimit/të vuajtjes së dënimit në Republikën e Shqipërisë”.

9. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Istituti i Zhvillimit të Arsimit dhe njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM**Nr. 44, datë 16.10.2014**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN E MASH NR. 21, DATË
23.7.2010 “PËR NORMAT E PUNËS
MËSIMORE-EDUKATIVE DHE
NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 26, pika d, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin e MASH-it nr. 21, datë 23.7.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, bëhen shtesa dhe ndryshime si vijon:

1. Në pikën “II. Arsimi bazë”:

Pika 1 bëhet: “Mësues në arsimin fillor

Pika 2 bëhet: “Mësues në arsimin e mesëm të ulët:

a) Mësues i gjuhës shqipe dhe letërsisë, i gjuhës së huaj, i matematikës, fizikës, biologjisë, kimisë, informatikës dhe histori-gjeografisë

b) Mësues i lëndëve të tjera 22 orë në javë



c) Mësues në institutet e fëmijëve me aftësi të kufizuara 20 orë në javë

d) Edukatorë (mësues ndihmës) në institutet e fëmijëve me aftësi të kufizuara

30 orë në javë”.

Pika 3 bëhet: “Drejtues:

a) Drejtor i shkollës me 81-300 nxënës

8 orë në javë

b) Drejtor i shkollës me 301-600 nxënës

6 orë në javë

c) Drejtor i shkollës me mbi 600 nxënës

4 orë në javë

d) Nëndrejtor i shkollës me 251-500 nxënës (një)

8 orë në javë

e) Nëndrejtor i shkollës me 501-900 nxënës (dy)

8 orë në javë

(Njëri nëndrejtor plotëson amzën dhe përgjigjet për të.

Nëndrejtori tjetër mban inventarin e shkollës dhe përgjigjet për të)

f) Nëndrejtor i shkollës me mbi 901 nxënës (tre)

8 orë në javë

(Nëndrejtori që plotëson amzën dhe përgjigjet për të dhe nëndrejtori tjetër që mban inventarin e shkollës dhe përgjigjet për të, kanë normën 6 orë në javë secili).

Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës mbulojnë normën e tyre me orë të profilit të diplomës që zotërojnë”.

Pika 4 bëhet: “Norma e kontrollit:

a) Drejtor i shkollës 4 orë në javë

(3 orë vëzhgim orësh mësimore dhe 1 orë kontroll dokumentacioni, pa llogaritur testet me shkrim)

b) Nëndrejtor i shkollës 4 orë në javë

(3 orë vëzhgim orësh mësimore dhe 1 orë kontroll dokumentacioni, pa llogaritur testet me shkrim)”.

2. Në pikën “III. Arsimi i mesëm”:

“III. Arsimi i mesëm i lartë

Pika 1 bëhet: “Mësues

a) Mësues i gjuhës shqipe dhe i letërsisë

18 orë në javë

b) Mësues i gjuhës së huaj, i matematikës, fizikës, biologjisë, kimisë, informatikës dhe histori-geografisë

20 orë në javë

c) Mësues i lëndëve të tjera

22 orë në javë

d) Mësues i praktikave profesionale

30 orë në javë.”.

Pika 2 bëhet: “Drejtues:

a) Drejtor i shkollës me 81-300 nxënës

8 orë në javë

b) Drejtor i shkollës me 301-600 nxënës

6 orë në javë

c) Drejtor i shkollës me mbi 600 nxënës

4 orë në javë

d) Nëndrejtor i shkollës me 251-500 nxënës

8 orë në javë

e) Nëndrejtor i shkollës

- me 501-900 nxënës (dy)

8 orë në javë

- me mbi 901 nxënës (tre)

8 orë në javë

Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës mbulojnë normën e tyre me orë të profilit të diplomës që zotërojnë.”.

Pika 3 bëhet: “Norma e kontrollit:

a) Drejtor i shkollës 3 orë në javë

(2 orë vëzhgim orësh mësimore dhe 1 orë kontroll dokumentacioni, pa llogaritur testet me shkrim)

b) Nëndrejtor i shkollës 4 orë në javë

(3 orë vëzhgim orësh mësimore dhe 1 orë kontroll dokumentacioni, pa llogaritur testet me shkrim).”.

Pika 4 bëhet: “Norma të tjera:

a) Shfuqizohet.

c) Shfuqizohet”.

3. Në pikën “IV. Norma të veçanta”:

Pika 2 bëhet:

“a) Mësuesit që drejton bibliotekën në shkollë dhe punon me librin, i llogariten:

- 3 orë në javë kur shkolla ka bibliotekë dhe ka 201-600 nxënës;

- 4 orë në javë kur shkolla ka bibliotekë dhe ka mbi 600 nxënës.

b) Për zhvillimin e veprimtarive konkrete të programuara në kuadër të shkollës si qendër komunitare (Sipas pikës 1.5 të shkresës së MAS-it nr. 1794 prot., datë 13.3.2014 “Standardet e shkollës si qendër komunitare”), llogariten 10 orë në javë.”.

Pika 4 bëhet: “Puna e mësuesit kujdestar në shkollat e arsimit parauniversitar barasvlerësohet me dy orë mësimore në javë. Kur mësuesi është i ngarkuar me normë të plotë mësimore, këto orë paguhën si orë mbi ngarkesën mësimore.”.

Pika 15 bëhet: “Mësuesi i arsimit parauniversitar e plotëson ngarkesën mësimore



javore me lëndë të profilit të tij. Kur nuk ka orë të mjaftueshme brenda profilit, ai ngarkohet me orë mësimore të profileve të përafërta, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij urdhri.”.

4. Në pikën “V. Numri i nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”:

Pika 2 bëhet: “Arsimi bazë

a) Klasa përgatitore formohet me 25 fëmijë.

b) Klasa e parë formohet me 26-30 nxënës.

c) Klasat II-V formohen me 30-35 nxënës.

d) Ndarja e klasave paralele bëhet sipas këtyre kushteve:

- 2 paralele, kur numri i nxënësve është nga 36-70 nxënës (31-60 nxënës për klasën e parë);

- 3 paralele, kur numri i nxënësve është nga 71-105 nxënës (61-90 nxënës për klasën e parë);

- 4 paralele, kur numri i nxënësve është 106-140 nxënës (91-120 nxënës për klasën e parë);

- 5 paralele, kur numri i nxënësve është mbi 140 nxënës (121-150 nxënës për klasën e parë).

Formimi i klasave kolektive bëhet sipas pikave a-e të udhëzimit 21.”.

Pika 3 bëhet: “Arsimi i mesëm i ulët

a) Klasat formohen me 30-35 nxënës.

b) Ndarja e klasave paralele bëhet sipas këtyre kushteve:

- 2 paralele, kur numri i nxënësve është nga 36-70 nxënës;

- 3 paralele, kur numri i nxënësve është nga 71-105 nxënës;

- 4 paralele, kur numri i nxënësve është 106-140 nxënës;

- 5 paralele, kur numri i nxënësve është mbi 140 nxënës.”.

Pika 4 bëhet: “Arsimi i mesëm i lartë

a) Klasat formohen me 30-35 nxënës.

b) Ndarja e klasave paralele bëhet sipas këtyre kushteve:

- 2 paralele, kur numri i nxënësve është nga 36-70 nxënës;

- 3 paralele, kur numri i nxënësve është nga 71-105 nxënës;

- 4 paralele, kur numri i nxënësve është 106-140 nxënës;

- 5 paralele, kur numri i nxënësve është mbi 140 nxënës.”.

5. Në pikën “VI. Drejtues në institucionet e arsimit parauniversitar”:

Pikat 1 “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g” shfuqizohen.

Faqe|9168

6. Pika VII bëhet: “VII. Qendrat kulturore të fëmijëve

6.1. QKF-të janë institucione arsimore plotësuese, që ndërtohen në bazë kursi dhe sektori.

a) Puna në çdo sektor do të funksionojë në bazë kursi. Çdo kurs ka dy grupe: grupi i të vegjëlve, që përfshin fëmijë të arsimit fillor me 4 orë në javë, dhe grupi i të rriturve me 6 orë në javë që përfshin fëmijë të arsimit të mesëm të ulët dhe drejtohen nga një instruktor.

b) Çdo sektor formohet me jo më pak se 10 kurse dhe ka në organikë një përgjegjës sektori.

c) Sektori me mbi 15 kurse të ndryshme ka në organikë dhe një instruktor efektiv të emëruar.

d) Grupi formohet me 15 deri 20 fëmijë. Grupet e instrumentistëve formohen me 4 fëmijë, ndërsa grupet e shahut, të pingpongut dhe të tenisit formohen secili me 8 fëmijë.

6.2. QKF-të organizohen në përputhje me kriteret e kategorizimit të tyre.

1. QKF-të janë të kategorisë së parë, kur kanë 5 sektorë dhe sallën e shfaqjeve me mbi 200 vende, si dhe mbulojnë një komunitet me mbi 10 mijë nxënës.

Sektorët e këtyre QKF-ve janë:

a) Sektori i veprimtarive masive;

b) Sektori i artit;

c) Sektori i sportit;

d) Sektori i shkencës;

e) Sektori ndihmës.

2. a) Drejtori i QKF-së i kategorisë së parë nuk drejton kurs. Ai është person administrativ që kontrollon gjithë veprimtarinë e QKF-së.

b) Përgjegjësi i sektorit në QKF-në e kategorisë së parë drejton një grup mësimor me 6 orë/javë, ndërsa instruktorët e sektorëve drejtojnë dy grupe mësimore ose 12 orë/javë.

c) Përgjegjësi i sektorit në QKF dhe instruktori efektiv përgjigjen drejtpërdrejt për aktivitetet artistike, sportive dhe shkencore për shkollat me më pak se 300 nxënës.

3. a) QKF-të janë të kategorisë së dytë, kur kanë 3 sektorë dhe sallën e shfaqjeve me mbi 100 vende, si dhe mbulojnë një komunitet me mbi 5 mijë nxënës.

Sektorët e këtyre QKF-ve janë:

1) Sektori i artit;

2) Sektori i sportit;

3) Sektori shkencor.



b) Drejtori i QKF-së së kategorisë së dytë drejton një grup mësimor ose 6 orë/javë.

c) Përgjegjësi i sektorit drejton një kurs me dy grupe mësimore ose 10-12 orë/javë.

4. QKF-të janë të kategorisë së tretë, kur dhe mbulojnë një komunitet me deri 5 mijë nxënës dhe do të kenë dy sektorë (sektorin art e sport dhe sektorin shkencor), me nga 8 kurse të ndryshme për çdo sektor. Ne këtë rast, QKF-të do të kenë një përgjegjës të QKF-së dhe 2 inspektorë të emëruar që do të drejtojnë nga një kurs me nga dy grupe secili kurs. Përgjegjësi i QKF-së do të drejtojë një grup me 6 orë/javë.”

II. Këto shtesa e ndryshime zbatohen në vitin shkollor 2014-2015 e në vazhdim.

III. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

SHTOJCË

Arsimi parashkollor dhe mësuesit sipas profilit

Nr.	Grupet	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1.	Grupi I, II, III	Bachelor për arsimin parashkollor	E mesme pedagogjike për edukatorë

Arsimi fillor (klasat I-V) dhe mësuesit sipas profilit

Nr.	Klasat	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1.	Klasat I, II, III, IV, V	Arsimi i lartë për CF (sistemi i vjetër, licencë mësuesi për arsimin fillor)	E mesme pedagogjike për mësuesi, shkalla I e kualifikimit

Arsimi i mesëm i ulët (Klasat VI-IX) dhe mësuesit sipas profilit

Nr.	Lëndët	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1.	Gjuhë amtare (Gjuhë shqipe)	Gjuhë shqipe-letërsi	
2.	Gjuhë e huaj	Gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht...)	Gjuhë e huaj; e mesme e gjuhëve të huaja e profilizuar për mësuesi, shkalla I e kualifikimit
3.	Matematikë	Matematikë-fizikë	Matematikë
4.	Fizikë	Matematikë-fizikë	Fizikë, matematikë
5.	Kimi	Biokimi	Kimi
6.	Biologji dhe edukim shëndetësor	Biokimi	Biologji
7.	Histori	Histori-Gjeografi	Histori, gjeografi
8.	Gjeografi	Histori-Gjeografi	Histori, gjeografi
9.	Edukatë shoqërore	Shkenca shoqërore	Histori-gjeografi, histori, gjeografi, gjuhë shqipe-letërsi
10.	Edukim figurative	Arte figurative	E mesme artistike e profilizuar për mësuesi, shkalla I e kualifikimit
11.	Edukim muzikor	Arte muzikore	E mesme e muzikës e profilizuar për mësuesi, shkalla I e kualifikimit
12.	Aftësim teknologjik	Inxhinieri	Shkencat e natyrës
13.	Edukim fizik	Edukim fizik	E mesme e fizikulturës e profilizuar për mësuesi, shkalla I e kualifikimit
14.	Informatikë	Informatikë, matematikë	Fizikë

Lëndët e gjimnazit dhe mësuesit sipas profilit

Kurrikula bërthamë

Nr.	Lëndët	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1.	Arte (muzikë, vallëzim teatër, art pamor), histori arti	Arte	Gjuhë shqipe letërsi, histori
2.	Edukim fizik dhe sporte	Edukim fizik	
3.	Gjuhë e huaj e parë	Gjuhë e huaj (anglisht,	Gjuhë e huaj (anglisht,



		frëngjisht...)	frëngjisht...)
4.	Gjuhë shqipe dhe letërsi	Gjuhë letërsi	
5.	Karriera	Shkenca shoqërore, ekonomi	Histori-gjeografi
6.	Aftësimi për jetën	Shkenca shoqërore	Biologji
7.	Matematikë	Matematikë	
8.	Kimi	Kimi	Biokimi
9.	Biologji	Biologji	Biokimi
10.	Fizikë	Fizikë	Matematikë-fizikë
11.	Shkenca e tokës, mjedisit dhe hapësirës	Gjeografi	Fizikë, fiokimi
12.	Shkencë (3 module: fizikë-kimi-biologji)	Kimi, fizikë, biologji	
13.	Qytetari	Shkenca shoqërore	
14.	Histori	Histori, gjeografi	Histori-gjeografi
15.	Gjeografi	Gjeografi, histori	Histori-gjeografi
16.	Ekonomi	Ekonomi	Shkenca shoqërore
17.	TIK	Informatikë, matematikë	Fizikë
18.	Teknologji	Inxhinieri	Fizikë, kimi

Kurrikula me zgjedhje

Nr.	Lëndët	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1.	Edukim fizik (Lojëra sportive)	Edukim fizik	
2.	Gjuhë e huaj e dytë	Gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht...)	Gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht...)
3.	Gjuhë shqipe dhe letërsi	Gjuhë shqipe-letërsi	
4.	Matematikë	Matematikë	
5.	Kimi	Kimi	
6.	Biologji	Biologji	
7.	Fizikë	Fizikë	
8.	Trashëgimi kulturore	Histori, gjeografi	Gjuhë shqipe-letërsi, shkenca shoqërore
9.	Sociologji	Shkenca shoqërore	
10.	Filozofi	Shkenca shoqërore	
11.	Psikologji	Psikologji	Shkenca shoqërore
12.	Histori	Histori	Gjeografi
13.	Gjeografi	Gjeografi	Histori
14.	Ekonomi	Shkenca shoqërore	
15.	TIK	Informatikë, matematikë	Fizikë
16.	Teknologji	Inxhinieri	Fizikë, kimi

VENDIM**Nr. 51, datë 12.11.2014****NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedjakryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 7.10.-

2014, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi

Faqe|9170

bazë dokumentesh, çështjen me nr. 38 Akti, që i përket:

KËRKUES: Thimjo Dhroso

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Vasil Çuni, bashkia Sarandë

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimeve: nr. 00-2012-1498, datë 22.06.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 468, datë 7.12.2009, të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër dhe nr. 628, datë 6.5.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.



GJYKATA KUSHTETUESE,

II

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuar dhe subjekti i interesuar V.Ç., janë banorë të një pallati dhe jetojnë në apartamente që ndodhen njëri mbi tjetrin. Pas mosmarrëveshjeve midis tyre, në lidhje me ndërtimet që subjekti i interesuar ka kryer në tarracën e pallatit, kërkuar ka aplikuar në Bashkinë Sarandë për një leje ndërtimi për shtesë kati. Me vendimin nr. 2/33, datë 17.11.2006, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Sarandë i ka dhënë kërkuarit leje ndërtimi për shtesë kati. Subjekti i interesuar i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke kërkuar shpalljes si të pavlefshëm të këtij vendimi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 238, datë 11.3.2008, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

2. Gjykata e Apelit Gjyrokastër, pas ankimit të ushtruar nga subjekti i interesuar, V.Ç., ka vendosur prishjen e vendimit nr. 238, datë 11.3.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe kthimin e çështjes për rigjykim me trup tjetër gjyqësor.

3. Pas rishqyrtimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 628, datë 6.5.2009, ka vendosur pranimin e pjesës së kërkesëpadisë dhe ka shpallur të pavlefshëm vendimin nr. 2/33, datë 17.11.2006 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Bashkisë Sarandë.

4. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuar dhe Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr. 468, datë 7.12.2009 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 628, datë 6.5.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-1498, datë 22.6.2012 ka vendosur, në dhomën e këshillimit, mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuar.

6. **Kërkuar**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar se vendimet gjyqësore, objekt kërkesë, janë rezultat i një procesi të parregullt ligjor. Me konkretisht ai pretendon se:

6.1 Vendimet gjyqësore konkrete nuk janë arsyetuar pasi gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë një përcaktim të saktë të marrëdhënies juridike në konflikt, gjykata e apelit nuk ka korrigjuar mangësitë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë nuk është shprehur për shkeljet e gjykatave më të ulëta, si dhe nuk ka paraqitur në vendim shkaqet e rekursit;

6.2 Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit, pasi megjithëse në rekurs janë parashtruar shkelje të standardeve kushtetuese, në vendim nuk janë dhënë shkaqet pse pretendimet e paraqitura nuk respektojnë kriteret e nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile.

7. **Subjekti i interesuar**, Vasil Çuni, ka paraqitur si vijon:

7.1 Kërkuar nuk ka paraqitur asnjë shkak që të përbëjë cenim të së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor;

7.2 Gjykata e Apelit Gjyrokastër ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e kërkuarit dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka zbatuar të gjitha detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër duke kryer një hetim të plotë gjyqësor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. *Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit në gjykatë*

8. Kërkuar ka pretenduar se vendimet gjyqësore, objekt shqyrtimi, nuk janë të arsyetuara. Sipas tij, gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë një përcaktim të saktë të marrëdhënies juridike në konflikt, ndërsa gjykata e apelit nuk ka korrigjuar mangësitë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Për sa i përket vendimit të Gjykatës së Lartë, kërkuar ka parashtruar se është i paarsyetuar pasi kjo e fundit nuk është shprehur lidhur me shkeljet e gjykatave më të ulëta dhe nuk ka paraqitur në vendim shkaqet e rekursit, duke i cenuar në këtë mënyrë kërkuarit edhe të drejtën e aksesit në gjykatë.



9. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin ligjor. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 3, datë 19.02.2013; nr. 8, datë 28.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 36, datë 25.07.2013 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura (*shih vendimet nr. 3, datë 23.1.2014 dhe nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në çështjen konkrete, nga aktet e paraqitura me kërkesën, nuk rezulton që vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Sarandë dhe Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, të cilat kundërshtohen, të jenë jologjike, të kenë kundërthënie, të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojnë elementet e trajtuara nga jurisprudenca kushtetuese e sipërcituar.

12. Për sa i përket vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata, bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe jurisprudencën e saj, ka nënvizuar se arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 34, datë 12.7.2013; nr. 108, datë 3.10.2012, dhe nr. 17, datë 17.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimin nr. 143, datë 7.12.2011 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

13. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se: “detyrimi që ka gjykata vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsytimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë” (...) “arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se, kur një Gjykatë e Lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51*).

14. Neni 310/1 i KPC-së parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar, në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Ndërsa për gjykimin në Gjykatën e Lartë, KPC-ja sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet (neni



475/ç) dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga Kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit (neni 480). Vlerësimi i rekursit është atribut i Gjykatës së Lartë dhe veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimet nr. 45, datë 23.7.2012; nr. 4, datë 25.2.2009; nr. 5, datë 26.1.2007 dhe nr. 8, datë 2.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Nisur nga parashikimet e dispozitave të lartpërmendura të KPC-së, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata ka nënvizuar se, në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë dhe të aksesit në gjykatë, brenda kuadrit të procesit të rregullt ligjor, përmbajtja e vendimit duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimin nr. 26, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Pavarësisht standardeve të arsyetimit që karakterizojnë vendimin e marrë në dhomën e këshillimit, Gjykata vëren se, në rastin konkret, vendimi i mospranimit të rekursit përmban, në pjesën hyrëse të tij, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit ka paraqitur rekurs pala e paditur (kërkuesi), por nuk përmban shkaqet që ai ka parashtruar në rekurs. Në rekurs kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë të gjykatës së apelit si vendime të dhëna në kundërshtim me ligjin. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në pjesën arsyetuese, është mjaftuar me përfundimin se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij.

17. Duke iu referuar jurisprudencës së saj, Gjykata thekson se, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën një element të

domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 15, datë 19.4.2013 dhe nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga analiza në tërësi e vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson se, për shkakun e lartpërmendur, rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Ato nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që arsyetimi të mos ketë një harmoni të brendshme. Për rrjedhojë, mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përbën një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës, duke krijuar dyshime, ndër të tjera, edhe për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuesit. Është detyrë e Gjykatës së Lartë të bëjë të mundur realizimin efektiv të së drejtës së aksesit, pa lënë shkas për ekuivoke në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin e pretendimeve të kërkuesve nga ana e saj (*shih vendimet nr. 28, datë 15.5.2014 dhe nr. 26, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Nisur nga argumentet e mësipërme, si dhe bazuar në qëndrimin e konsoliduar të jurisprudencës kushtetuese në këtë drejtim, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata çmon se, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash¹,

¹ Gjyqtari V. Kristo votoi për rrëzimin e kërkesës, sipas qëndrimit të shprehur në mendimin e pakicës së vendimit nr. 34, datë 13.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese.



VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2012-1498, datë 22.6.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuar Thimjo Dhroso etj., jam kundër qëndrimit të shumicës për shfuqizimin e vendimit nr. 1498, datë 22.6.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vetëm me argumentin se në vendimin e dhomës së këshillimit mungon parashtrimi i shkaqeve të ngritura në rekurs.

2. Ashtu siç jam shprehur edhe më parë lidhur me këtë qëndrim të Gjykatës, vlerësoj se ai, megjithëse shërben për të ndrequr një mangësi në formulimin e vendimeve të mospranimit nga kolegjet e Gjykatës së Lartë është i padobishëm dhe i jep vendimmarrjes së shumicës një karakter formal, duke mos i shërbyer aspak kërkuarve, të cilët pretendimet për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor i lidhin me cenimin e të drejtave të tjera kushtetuese të tyre.

3. Në lidhje me parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson zbatimin e tij rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme këtë detyrim (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, ndërsa ka pranuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues, ka pranuar gjithashtu se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore,

vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Duke shkuar më tej, Gjykata nuk ka pranuar pretendimet për cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 21, datë 1.10.2008; nr. 40, datë 22.9.2011; nr. 18, datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19, datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë. Në rast se Gjykata nuk arrin në një përfundim të tillë, pra që procesi i zhvilluar në të tri shkallët e gjykimit është i cënueshëm nga pikëpamja kushtetuese, ajo nuk mundet që të shfuqizojë një vendim të Gjykatës së Lartë, vetëm me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqet e paraqitura në rekurs. Megjithatë, në vlerësimin tim, kjo nuk e pengon Gjykatën që, edhe në rastet e mospranimit të kërkesës, t'i tërheqë vërejtje Gjykatës së Lartë në mënyrë që të riparojë këto të meta në të ardhmen.

5. Në rastin konkret kërkuar ka pretenduar se vendimet gjyqësore nuk janë arsyetuar, pasi gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë një përcaktim të saktë të marrëdhënies juridike në konflikt, gjykata e apelit nuk ka korrigjuar mangësitë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë nuk është shprehur për shkeljet e gjykatave më të ulëta, si dhe nuk ka paraqitur në vendim shkaqet e rekursit. Sipas tij, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit,



pasi megjithëse në rekurs janë parashtruar shkelje të standardeve kushtetuese, në vendim nuk janë dhënë shkaqet pse pretendimet e paraqitura nuk respektojnë kriteret e nenit 472 të KPC-së. Në vendimin e saj shumica ka vlerësuar se nga aktet e paraqitura bashkëlidhur kërkesës, nuk rezulton që vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, të cilat kundërshtohen, të jenë jologjike, të kenë kundërthënie, të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojnë elementët e trajtuar nga jurisprudenca kushtetuese e sipërcituar. Për sa i përket vendimit të Gjykatës së Lartë, shumica vlerëson se rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Pjesët e vendimit nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda tij, çka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tij të mos kenë një harmoni të brendshme dhe se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës. Po ashtu, shumica vlerëson se, mosparaqitja, në vendimin e Kolegjit Civil, të shkaqeve të parashtruara nga kërkuesit në rekurs, *prima facie*, krijon dyshime edhe mbi cenimin e së drejtës së ankimit efektiv, si dhe të së drejtës për t'u dëgjuar.

6. Gjykata ka theksuar se detyrimi që kanë gjykatat për të arsyetuar vendimet e tyre, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 35, datë 25.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Gjykata është shprehur edhe lidhur me zbatimin e këtij detyrimi nga Gjykata e Lartë, për vendimet e dhëna prej saj në dhomë këshillimi, duke theksuar se mënyra e formulimit të pjesës arsyetuese të këtij vendimi, se “*rekursi nuk përmban shkaqe ligjore*”, është e rregullt. Fakti se në

këtë pjesë të vendimit nuk u jepet përgjigje e detajuar të gjitha pretendimeve të palëve, nuk do të thotë se ky vendim është i paarsyetuar, përderisa shkaqet e parashtruara në rekurs, që serviren si shkaqe ligjore për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, nuk gjejnë mbështetje as në ligj dhe as në materialet e çështjes. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh, në thelb, shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraparak në dhomën e këshillimit dhe nuk paraqet ndonjë mangësi, e cila mund të ndikojë negativisht në drejtim të garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 17, datë 16.5.2011; nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 37, datë 19.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Të njëjtin qëndrim mban edhe GJEDNJ-ja, e cila ka vlerësuar se kur Gjykata e Lartë nuk pranon një rekurs për shkak se nuk është parashtruar baza ligjore e çështjes, kërkesat e nenit 6 të Konventës mund të plotësohen me një arsyetim shumë të kufizuar (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007 §105; Mishgijoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51*).

9. Bazuar në standardet e mësipërme vlerësoj se, në rastin konkret, për sa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, kjo do të thotë se të gjitha shkaqet e ngritura në të nga kërkuesi, edhe pse nuk janë paraqitur formalisht në atë vendim, kanë qenë të pabazuara. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se në vendim nuk paraqet cilat janë shkaqet e kundërshtimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, në dhomën e këshillimit ka realizuar një proces vlerësimi të atyre shkaqeve, nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv. Gjithashtu, vendosja e shkaqeve në vendim vetëm formalisht, nuk është e mjaftueshme për të arritur në përfundimin se është realizuar vëzhgimi publik në administrimin e drejtësisë apo e drejta e aksesit, siç shprehet shumica. Për aq kohë sa shumica konstaton se vendimet gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit nuk rezulton të jenë jologjike, të kenë kundërthënie, të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojnë elementët e trajtuar nga jurisprudenca kushtetuese, pra pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara në lidhje me këto gjykime, shfuqizimi i vendimit të Gjykatës



së Lartë është thjesht formalizëm. Nga kjo pikëpamje, vlerësoj se ky element i vendimit të dhomës së këshillimit ka karakter thjesht formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor.

10. Edhe po t'i referohemi nenit 310/1 të KPC-së, i cili parashikon elementet që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor, vendosja e shkaqeve të ankimit nuk është parashikuar si një nga elementet që duhet të përmbajë pjesa hyrëse, përshkruese apo arsyetuese e vendimit. Kjo dispozitë kërkon nga gjykata paraqitjen e arsyeve në të cilat ajo mbështet vendimin, që në rastin konkret është mungesa e shkaqeve të parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

11. Në përfundim të analizës së mësipërme, vlerësoj se, për arsye se nga procesi gjyqësor nuk rezultoi cenimi i standardeve të një procesi të rregullt ligjor, Gjykata nuk duhej të vendoste shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, vetëm për arsyen e mosparaqitjes në të, të shkaqeve të rekursit.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr. 52, datë 14.11.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedjakryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 5.6.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 25 Akti, që i përket palëve:

KËRKUESE: Aurora Topçiu

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 00-2013-579, datë 25.4.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Faqe|9176

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 185, datë 13.12.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka vendosur: *“Deklarimin fajtorë të të pandeburës Aurora Topçiu, për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 250 mijë lekë gjobë.*

Deklarimin fajtorë të të pandeburës Aurora Topçiu, për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 250 mijë lekë gjobë.

Në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve, e pandebura Aurora Topçiu dënohet me 450 mijë lekë gjobë.

Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, të pandeburës Aurora Topçiu i ulet 1.3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht me 300.000 lekë gjobë...”

2. Me vendimin nr. 79, datë 16.05.2007, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit penal nr. 185, datë 13.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë si më poshtë:*

Deklarimin fajtorë të të pandeburës Aurora Topçiu, për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 450.000 lekë gjobë.

Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e të pandeburës Aurora Topçiu me 300.000 lekë gjobë.”

3. Me vendimin nr. 505, datë 14.10.2009, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkesja ndaj vendimit nr. 79 datë 16.5.2007, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, me arsyetimin se nuk është paraqitur në formën e



kërkuar nga ligji, pasi mungon nënshkrimi i mbrojtësit, sipas nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

4. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal, duke pretenduar mohimin e së drejtës së aksesit në atë Gjykatë.

5. Me vendimin nr. 39, datë 21.9.2011, Gjykata Kushtetuese ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit nr. 505, datë 14.10.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

6. Pas kthimit të çështjes për rishqyrtim, me vendimin nr. 00-2013-579, datë 25.4.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Aurora Topçiu, për arsye se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

7. Me kërkesën e datës 26.3.2014, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, për shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

II

8. **Kërkuesja Aurora Topçiu**, paraqet këto shkaqe në mbështetje të pretendimit të saj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor:

8.1 Është cenuar *e drejta e aksesit*, pasi edhe pse Kolegjit Penal i njihet e drejta për mospranimin e rekursit, në bazë të nenit 433 të KPP-së, në rastin konkret vendimi i mospranimit bie në kundërshtim të plotë me vendimin e mëparshëm të këtij Kolegji, të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese (nr. 505, datë 14.10.2009), i cili kishte vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, pasi kishte vlerësuar se rekursi plotësonte kërkesat e parashikuara nga ligji procedural për t'iu nënshtruar shqyrtimit gjyqësor.

8.2 Mospranimi, në dhomë këshillimi, i të njëjtit rekurs që më parë ishte vlerësuar të kalonte për shqyrtim në seancë gjyqësore, ka shkaktuar mosgjykimin e thelbit të pretendimeve të ngritura në të dhe marrjen e një përgjigje përfundimtare lidhur me to.

8.3 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vepruar në kundërshtim me vendimmarrjen e tij të mëparshme dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 39, datë 21.9.2011, i cili ka

vendosur detyrimin e rishqyrtimit të rekursit në seancë gjyqësore, ashtu si më parë ishte vendosur nga ky Kolegj, por në asnjë rast jo në dhomë këshillimi. Gjykata Kushtetuese nuk ka synuar ridërgimin e çështjes në dhomë këshillimi, pasi kjo do të nënkuptonte një farë kontrolli të ushtruar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndaj vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila është shprehur me vendim për shfuqizimin e një vendimi të seancës gjyqësore.

8.4 Është cenuar *standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Kolegjit Penal (dhomë këshillimi) është mjaftuar me rrëzimin e pretendimeve të ngritura në rekurs, por pa u ndalur e pa argumentuar arsyet në bazë të të cilave e ka gjetur të arsyetuar vendimin e gjykatës së apelit.

9. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës Kushtetuese, paraqet këto prapësime:

9.1 Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë është i pabazuar. Në nenin 432 të KPP-së janë parashikuar shkaqet për të cilat mund të bëhet rekurs, ndërsa në nenin 433 parashikohet se ai nuk mund të pranohet nëse bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji. Në rastin në shqyrtim, rezulton se Kolegji Penal ka analizuar dhe vlerësuar shkaqet e paraqitura në rekurs dhe ka arritur në përfundimin se ato nuk plotësojnë kërkesat e nenit 432 të KPP-së.

9.2 Kërkuesja e ka realizuar të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë si nga pikëpamja formale ashtu edhe substanciale. Gjykata Kushtetuese e ka shfuqizuar vendimin nr. 505, datë 14.10.2009 të Gjykatës së Lartë vetëm për shkakun formal të mosnënshkrimit të rekursit nga mbrojtësi, por ajo nuk ka vendosur asnjë kufizim, nuk ka lënë asnjë detyrë dhe/ose nuk ka orientuar për mënyrën e rishqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Në këto kushte, pas hedhjes së çështjes në short, shqyrtimi i saj në dhomë këshillimi, nuk përbën cenim të së drejtës së aksesit, për sa kohë që pretendimet e paraqitura në rekurs janë marrë në shqyrtim në atë Kolegj.

9.3 Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i pabazuar. Vendimi i Kolegjit Penal është i arsyetuar, si sepse pretendimet e paraqitura në rekurs nuk përbëjnë



shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së, ashtu edhe sepse vendimi i gjykatës së apelit është i bazuar në prova. Nga përmbajtja e vendimit nuk rezulton që ai të jetë jologjik, apo të mos u jetë referuar fakteve të provuara objekt gjykimi por, përkundrazi, ai është marrë në referencë të ligjit të zbatueshëm dhe ka përmbushur kërkesat e nenit 142/1 dhe 42 të Kushtetutës. Si në jurisprudencën kushtetuese, ashtu edhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është konsoliduar qëndrimi se kjo formë arsyetimi e vendimeve të dhomës së këshillimit nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë

10. Kërkesja pretendon cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, për arsye se Kolegji Penal i asaj Gjykate, pas kthimit të çështjes për rishqyrtim nga Gjykata Kushtetuese, ka vlerësuar në dhomë këshillimi plotësimin e kërkesave të nenit 432 të KPP-së, edhe pse vendimi i shfuqizuar i përkiste seancës gjyqësore. Ky qëndrim i Gjykatës së Lartë, sipas kërkesës, ka shkaktuar mosgjykimin e thelbit të pretendimeve të ngritura në rekurs dhe marrjen e një përgjigjeje përfundimtare lidhur me to.

11. Në nenin 42/2 të Kushtetutës, parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit i garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk

përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 6, datë 26.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses (*shih vendimet nr. 17, datë 18.7.2008; nr. 5, datë 6.3.2009; nr. 48, datë 24.9.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Bazuar në standardet e mësipërme, si dhe në rrethanat e çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar edhe më parë kësaj Gjykate, për të kundërshtuar vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (nr. 505, datë 14.10.2009), me të cilin ishte vendosur, në seancë gjyqësore, mospranimi i rekursit për shkak të mungesës së nënshkrimit nga mbrojtësi i kërkesës. Me vendimin nr. 39, datë 21.09.2011, Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin e këtij vendimi, me arsyetimin se “*parashikimi ligjor i nenit 435/2 të KPP-së nuk mund të interpretohet në një mënyrë të tillë, që do të cenonte thelbin e së drejtës së një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë. Në situatën në të cilën kërkesja ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të saj formale, që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur, ajo nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i saj të shqyrtohet në themel, vetëm për mungesë të nënshkrimit të mbrojtësit. Një interpretim i ndryshëm, që mund t'i bëhet nenit 435/2, sjell si pasojë cenimin e së drejtës së individit për akses në Gjykatën e Lartë.*” Pas kthimit të çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, Kolegji Penal i asaj Gjykate, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij për mungesë të shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.



13. Gjykata ka theksuar se vlerësimi i respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, bëhet prej saj rast pas rasti dhe në varësi të rrethanave konkrete të çështjes në shqyrtim. Gjykata ka theksuar edhe se, jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Detyra e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse procesi, në tërësinë e tij, ka qenë i drejtë (*shih vendimet nr. 40, datë 22.9.2011; nr. 18, datë 31.3.2014; nr. 26, datë 9.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në nenin 432 të KPP-së janë parashikuar shkaqet për të cilat mund të paraqitet rekurs, kurse në nenin 433 të KPP-së parashikohet se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe se mospranimi i tij vendoset nga Kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Në jurisprudencë konstante, Gjykata ka theksuar se, në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato shkaqe që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimet nr. 8, datë 2.5.2006; nr. 5, datë 26.1.2007; nr. 4, datë 25.2.2009; nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rekurs, të paktën formalisht, palët përpiqen të ngrenë para Gjykatës së Lartë shkaqe nga ato të parashikuara nga dispozitat procedurale përkatëse dhe, për këtë arsye, shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë, nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs,

por ai konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rastet kur kolegji konstaton se shkaqet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes së tyre, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, bindjen e brendshme të gjykatave të shkallëve më të ulëta apo me shkaqe që objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, ka të drejtë të mos e pranojë rekursin. Kjo është edhe përgjigja që i jep Gjykata e Lartë pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët.

16. Në rastin konkret Gjykata vëren se, në procesin gjyqësor të shfuqizuar prej saj (vendimi nr. 505, datë 14.10.2009), edhe pse çështja penale në ngarkim të kërkueses ishte kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka bërë asnjë vlerësim lidhur me themelin e pretendimeve dhe nuk ka dhënë asnjë vlerësim lidhur me shkaqet e paraqitura në atë rekurs, për arsye të konstatimit të mungesës së nënshkrimit të mbrojtësit, çka ka çuar në vendimin e mospranimit të tij. Në këto kushte, për sa kohë që shqyrtimi gjyqësor nuk kishte nisur ende në atë gjykatë, edhe pse formalisht vendimi i shfuqizuar i përkiste seancës gjyqësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk kishte asnjë pengesë që, pas kthimit të çështjes nga Gjykata Kushtetuese, t'ia nënshtronte vlerësimin të dhomës së këshillimit ekzistencën dhe bazueshmërinë e shkaqeve të paraqitura në rekurs. Po ashtu, Gjykata nuk konstaton cenim të së drejtës së aksesit në gjykatë, për sa kohë që pretendimet e paraqitura në rekurs janë marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit, dhe ajo i ka dhënë kërkueses përgjigje lidhur me to, në rastin konkret, se ato nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së.

17. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenim të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë është i pabazuar.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

18. Kërkuësja pretendon se është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Kolegjit Penal (dhomë këshillimi) është mjaftuar me rrëzimin e pretendimeve të ngritura në rekurs, por pa u ndalur dhe pa argumentuar arsyet në bazë të të cilave e ka gjetur të arsyetuar vendimin e gjykatës së apelit.



19. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 8, datë 16.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 20, datë 13.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Vlerësimi i zbatimit të këtij parimi bëhet nga Gjykata rast pas rasti, pasi detyrimi për arsyetimin e vendimit gjyqësor nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në

fjalë (*shih vendimet nr. 36, datë 26.07.2011; nr. 3, datë 19.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në lidhje me vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, Gjykata ka vlerësuar se arsyetimi i kufizuar i këtyre lloj vendimesh nuk cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit dhe kërkesat e një procesi të rregullt ligjor mund të plotësohen edhe me një arsyetim të kufizuar të këtyre vendimeve (*shih vendimet nr. 36, datë 26.07.2011; nr. 34, datë 12.07.2013; vendimet nr. 6, datë 10.02.2014; nr. 17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vëren se në rastin konkret në shqyrtim, vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomë këshillimi, përmban, në pjesën hyrëse të tij, si disponimet e gjykatave më të ulëta ashtu edhe shkaqet e parashtruara në rekurs, kurse në pjesën arsyetuese të vendimit janë pasqyruar argumentet se përse pretendimet e paraqitura nga kërkuesja janë të pabazuara. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka realizuar një proces vlerësimi të shkaqeve të ngritura në rekurs, që janë paraqitur si shkaqe ligjore për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, u ka dhënë atyre përgjigje në vendimin e tij të dhomës së këshillimit. Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë, i kundërshtuar, plotëson kërkesat e neneve 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe, për pasojë, ky pretendim i kërkueses është i pabazuar.

24. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses, lidhur me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “P” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,



VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se jemi kundër qëndrimit të shumicës, në çështjen me kërkuese Aurora Topçiu, vlerësojmë të parashtrojmë argumentet tona si gjyqtarë në pakicë.

2. Kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, për arsye se, në kushtet kur vendimi i shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese i përkiste seancës gjyqësore, pas kthimit të çështjes për rishqyrtim nga kjo Gjykatë, Kolegji Penal duhej ta shqyrtonte çështjen po në seancë gjyqësore dhe nuk mund të merrte më në shqyrtim, në dhomë këshillimi, bazueshmërinë e shkaqeve të paraqitura në rekurs.

3. Në bazë të nenit 407/3 të KPP-së, mjetet e ankimit janë apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikim. Në nenin 432 të KPP-së janë parashikuar shkaqet për të cilat mund të paraqitet rekurs në Gjykatën e Lartë, kurse në nenin 433 të KPP-së parashikohet se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe se mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Në rast se kolegji i Gjykatës së Lartë vlerëson se rekursi përmban shkaqe ligjore, atëherë çështja i kalon për shqyrtim seancës gjyqësore, e cila shprehet lidhur me themelin e pretendimeve.

4. Sa më sipër është procedura që ndiqet në rastet kur Gjykata e Lartë vihet në lëvizje me anë të rekursit. Në çështjen konkrete në shqyrtim, Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje jo më nëpërmjet rekursit, por si pasojë e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar vendimin e Kolegjit Penal të dhënë në seancë gjyqësore dhe ka dërguar çështjen për rishqyrtim

në po atë gjykatë. Në raste të tilla, procedura që ndiqet në Gjykatën e Lartë nuk mund të jetë e njëjtë me atë të parashikuar në dispozitat e mësipërme procedurale, por një procedurë e ndryshme nga ajo e lartpërmendur pasi, si rregull, çështja kthehet për rishqyrtim në atë fazë në të cilën është konstatuar shkelja, pra në dhomën e këshillimit nëse vendimi i shfuqizuar i përket kësaj fazë, dhe në seancë gjyqësore nëse vendimi i shfuqizuar i përket fazës së shqyrtimit gjyqësor. Në rastin e fundit, si rregull, çështja hidhet në short për t'u caktuar gjyqtari relator, dhe sipas radhës së gjykimit, ajo shpallet në listat e gjykimit në seancë, të cilat afishohen pranë Gjykatës së Lartë.

5. Në rast se do të pranohet të kundërtën, pra se në rast të shfuqizimit të një vendimi të seancës gjyqësore nga Gjykata Kushtetuese (pavarësisht shkeljes konkrete), shkaqet e paraqitura në rekurs do t'i nënshtroheshin sërish vlerësimit të dhomës së këshillimit, atëherë do të vihej në dyshim vlera detyruese e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, në kushtet kur Gjykatës nuk iu vu në dispozicion nga ana e Gjykatës së Lartë një informacion zyrtar në lidhje me procedurën e ndjekur në të tilla raste, edhe nëse do të pranohet se procedura që ndiqet në Gjykatën e Lartë pas kthimit të çështjes nga Gjykata Kushtetuese është e njëjtë me atë kur ajo vihet në lëvizje në bazë të rekursit, përsëri vlerësojmë se kjo nuk mund të përbëjë përveçse një hap/veprim formal procedural, por në asnjë mënyrë nuk mund të pranojmë që kolegji përkatës mund të ribëjë një rivlerësim në themel të shkaqeve të paraqitura më parë në rekurs.

6. Nëse do t'i referoheshim për analogji edhe vendimeve të GJEDNJ-së, sipas kërkesave të nenit 46 të KEDNJ-së, një shtet palë për të cilin GJEDNJ-ja është shprehur se ka shkelur Konventën ose Protokollin e saj, ka detyrimin që të veprojë në përputhje me vendimin e asaj Gjykate. Shteti ka detyrimin jo vetëm të shlyejë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrë masa individuale dhe/ose, nëse është e përshtatshme, masa të përgjithshme në rendin e vet ligjor, që t'i japë fund shkeljes së gjetur nga Gjykata dhe të rregullojë pasojat e shkeljes, me qëllimin që kërkuesi të rikthehet, për aq sa është e mundur, në gjendjen që ishte para se të bëhej shkelja (*vendimi në çështjen Scozzari dhe*



Giunta kundër Italisë, nr. 39221/98 dhe 41963/98, § 249, ECHR 2000-VIII, dhe Assanidze kundër Gjeorgjisë, nr. 71503/01, § 198, ECHR 2004-II). Në vendimet e saj, GJEDNJ-ja ka shprehur parimin e njohur të së drejtës ndërkombëtare *restitutio in integrum*, i cili është përdorur shpesh nga Komiteti i Ministrave në rezolutat e tij. Edhe pse në lidhje me mënyrën se si do të zbatojnë detyrimet e parashikuara në nenin 46 të Konventës për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, shtetet palë të Konventës gëzojnë diskrecion dhe Konventa nuk përmban dispozita që t'u imponojë Palëve Kontraktuese detyrimin për të parashikuar në ligjin e brendshëm rishqyrtimin apo rihapjen e procedimeve, ekzistenca e mundësive të tilla, në rrethana të veçanta, ka provuar të jetë e rëndësishme dhe, në disa raste, i vetmi mjet për të arritur *restitutio in integrum* (shih vendimin nr. 45, datë 1.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

7. Qëllimi i masave individuale, e individualizuar në atë që konsiderohet *restitutio in integrum* të personit, është që të vendosin individin, për sa është e mundur, në një situatë të njëjtë me atë në të cilën do të gjendej nëse nuk do të kishte një shkelje të Konventës. Kur një individ është dënuar si pasojë e një procesi jo të drejtë, mjeti më i përshtatshëm për të riparuar shkeljen është një proces i ri ose riçelja e procedimeve, duke respektuar të gjitha kërkesat e një procesi të drejtë.

8. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t'i cenohen kërkuessit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore. Mungesa ose jo e shkaqeve duhet verifikuar paraprakisht nga Kolegji në dhomën e këshillimit dhe në rast se ai vendos kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, Gjykata e Lartë ka detyrimin t'i japë rekursuesit mundësinë të shprehet mbi themelin e shkaqeve të rekursit për të vendosur, më pas, sipas parashikimeve të nenit 441 të KPP-së. Në momentin që çështja kalon për gjykim, prezumohet se kërkuessit i është njohur e drejta për t'u dëgjuar në një seancë publike nga një gjykatë e pavarur e paanshme dhe e caktuar me ligj, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Po ashtu, dispozitat procedurale e lidhin zhvillimin e

seancës gjyqësore me faktin që palët duhet të dëgjojnë për pretendimet dhe bazueshmërinë e tyre në ligj dhe prova. Në këtë fazë nuk mund të diskutohet nëse janë plotësuar shkaqet për shqyrtim gjyqësor, pasi kjo gjë prezumohet se është kryer në fazën paraprake, por Gjykata e Lartë ka detyrimin të dëgjojë palët në seancën që zhvillohet për këtë qëllim (shih vendimin nr. 32, datë 22.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

9. Për sa më sipër vlerësojmë se, në rastin konkret, procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk ka respektuar kërkesat e një procesi të rregullt ligjor. Në kushtet kur çështja kishte kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore, do të thotë se kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë kishte vlerësuar se rekursi përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Në mënyrë që kërkuessit t'i vihej në vend e drejta për një proces të rregullt ligjor, e konstatuar e shkelur nga Gjykata Kushtetuese, ajo duhej të kthehej në atë fazë të procesit, në të cilën do të ndodhej nëse nuk do të kishte ndodhur kjo shkelje, pra në seancë gjyqësore. Duke i vlerësuar, sërish, në dhomë këshillimi, shkaqet e paraqitura në rekurs, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk i ka dhënë mundësi kërkuessit të dëgjojnë lidhur me rekursin, duke i mohuar në këtë mënyrë të drejtën e aksesit në atë gjykatë. Po ashtu, ky qëndrim i Gjykatës së Lartë cenon edhe parimin e sigurisë juridike, për shkak të mosrespektimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

10. Në përfundim, vlerësojmë se kërkesa e paraqitur nga kërkuessja Aurora Topçiu është e bazuar dhe se Gjykata duhej të vendoste shfuqizimin e vendimit të dhomës së këshillimit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, në seancë gjyqësore.

Anëtarë: Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo

**VENDIM****Nr. 96, datë 27.10.2014****PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
OPERATORI I SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHA NË
AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, pika 1, germa “c”, 13, 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.10.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., për licencimin në aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike,

konstatoi:

- Paraqitjen përgjithësisht të dokumentacionit nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike shoqërinë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE) për një afat 30-vjeçar.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga Bordi i Komisionerëve, sipas nenit 16 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, si dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrît Ahmeti**

VENDIM**Nr. 97, datë 27.10.2014****PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
OPERATORI I SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHA NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT PUBLIK
ME PAKICË TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 13, 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.10.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike,

konstatoi:

- Paraqitjen përgjithësisht të dokumentacionit nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë në aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike shoqërinë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE) për një afat 5-vjeçar.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga Bordi i Komisionerëve, sipas nenit 16 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, si dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrît Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 98, datë 27.10.2014****PËR PËRFUNDIMIN E
ADMINISTRIMIT TË PËRKOHSHËM
TË SHOQËRISË OPERATORI I
SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHA (OSHEE)**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 18, pika 5, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimeve të Bordit të Komisionerëve nr. 96, datë 27.10.2014, si dhe nr. 97, datë 27.10.2014, për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. në aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.10.2014,

konstatoi se:

- Në bazë të vendimit nr. 5, datë 21.1.2013, aktiviteti i shpërndarjes dhe ai i furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike kryhet aktualisht nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE) në administrim të përkohshëm;

- Me vendimet nr. 96, datë 27.10.2014, si dhe nr. 97, datë 27.10.2014, Bordi i Komisionerëve vendosi licencimin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. në aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e administrimit të përkohshëm të shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE), sipas vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 5, datë 21.1.2013.

2. Shfuqizimin e akteve nënligjore të mara në zbatim të vendimit nr. 5, datë 21.1.2013.

3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, si dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM**Nr. 145, datë 31.10.2014****PËR REVOKIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“INTERALBANIAN VIENNA
INSURANCE GROUP” SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, dhe nenit 155, germa “g”, të ligjit nr. 52, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

konstatoi se:

Autoriteti me vendimin nr. 133, datë 30.9.2014, ka miratuar bashkimin me përthithje të shoqërisë së sigurimit “Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a. (shoqëria e përthithur) me shoqërinë e sigurimit “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a. (shoqëria përthithëse).

Në datën 9.10.2014, Qendra Kombëtare e Regjistrimit ka kryer regjistrimin e bashkimit me përthithje të shoqërisë së sigurimit “Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a. (shoqëria e përthithur) me shoqërinë e sigurimit “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a. (shoqëria përthithëse) në përputhje me dokumentacionin e depozituar.

Në bazë të nenit 220, germa “c”, regjistrimi i bashkimit të shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit bën që shoqëria që përthithet të vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, pa kaluar në procesin e likuidimit.

Në bazë të nenit 155, germa “g”, të ligjit nr. 52, datë 22.5.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i revokon licencën shoqërisë së sigurimit për të ushtruar veprimtari sigurimi nëse shoqëria e sigurimit prishet.

Për sa më sipër, Autoriteti

VENDOSI:

1. Revokimin e licencës së shoqërisë së sigurimit “Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a., për të ushtruar veprimtari sigurimi në Republikën e Shqipërisë.



2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Enkelelda Shehi

KËRKESË
Nr. 6979, datë 13.11.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Shkodër-Hani i Hotit (objekte)”. Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe për llogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONËSIMEVE

LISTA EMERORE E PRONAREVE QE SHPRONËSOHEN PER OBJEKTET QE PREKEN NGA NDERTIMI
RUGES SHKODER-HANI I HOTIT (Pas ndryshimit te projektit)

Lista nr.2

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. Pasurise	Emertimi i objektit	Vlera	Shenime
1	Tom		Gjetja	1465	803/2	Mure rrethues	660672	leje ndertimi
2	Gjon		Curraj	1020	110	Mure rrethues	498294	leje ndertimi
3	Pashko		Kokaj	1964	986	Karburant	8615707	leje ndertimi
4	Shoq. "Ada Petrol"	Agustin	Uldedaj	1964	992	Karburant	953232	leje ndertimi
5	Smajl, Fatmir	Ali	Rexha	1766	1067/19	Mure rrethues	920695	leje ndertimi
	SHUMA						11648600	

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit objekte.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 11648600 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

**KËRKESE**

Shtetasit Mihal Kote dhe Natasha Kote
kërkojnë, pranë Gjykatës së Rrethit Berat,
shpalljen të zhdukur të djalit të tyre, Dritan
Kote, i datëlindjes 15.2.1971, dhe caktimin e një
kujdestari për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKUES**Mihal Kote****Natasha Kote**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 36 lekë